



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
Departamenti i Auditimit të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore
KRYETARI

Adresa: Rruga "Abdi Toptani" Nr.1 Tiranë.

E-mail: klsh.org.al; web-site www.klsh.org.al

Nr. 603 / 7 Prot.

Tiranë, më 25. 12. 2019

V E N D I M

Nr. 160, Datë 25.12.2019

PËR

**AUDITIMIN E USHTRUAR NË BASHKINË TEPELENË “MBI AUDITIMIN
FINANCIAR DHE TË PËRPUTHSHMËRISË”
(Për periudhën nga data 01.01.2017 deri më datën 30.09.2019)**

Në auditimin e ushtruar në Bashkinë Tepelenë, rezultuan devijime nga kuadri rregullator në fuqi (kriteret), të cilat në gjykimin profesional të audituesit janë materiale (por jo të përhapura), efektet e të cilave justifikojnë dhënien e një opinionit të kualifikuar (të modifikuar). Fushat kryesore të cilat janë konstatuar anomali janë pasqyrat financiare, buxheti, të ardhurat nga taksat e tarifatat vendore, sistemi i kontrollit të brendshëm.

Pasi u njoha me Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe Projektvendimin e paraqitur nga Grupi i Auditimit të Departamentit të Auditimit të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore, shpjegimet dhe komentet e dhëna nga subjekti i audituar, vlerësimet mbi objektivitetin dhe cilësinë e auditimit të dhëna nga Kryeaudituesi dhe Drejtori i Departamentit të mësipërm, Drejtori i Drejtorisë së Standardeve dhe Sigurimit të Cilësisë së Auditimit, si dhe Drejtori i Përgjithshëm, në mbështetje të neneve 10, 15, 25 dhe 30, të ligjit nr. 154/2014 miratuar në datën 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, me qëllim përmirësimin e gjendjes,

V E N D O S A:

I. Të miratoj Raportin Përfundimtar të Auditimit “Mbi auditimin financiar dhe të përputhshmërisë në Bashkinë Tepelenë”, sipas programit të auditimit nr. 603/1 prot, datë 26.08.2019 dhe shkresës “Njoftim për ndryshim në programin e auditimit”, nr.603/2 prot., datë 21.10.2019, për periudhën nga data 01.01.2017 deri më datën 30.09.2019.

II. Të miratoj Opinionin e Auditimit, rekomandimet për përmirësimin e gjendjes dhe të kërkoj marrjen e masave sa vijon:

A. OPINIONI I AUDITIMIT

Opinion i kualifikuar për pasqyrat financiare.

Opinionin e dhënë mbi besueshmërinë e llogarive vjetore e mbështesim në konstatimet se deklaratat e të ardhurave, shpenzimeve, banka, etj., janë përfshirë në deklaratat financiare. Janë marrë evidenca të mjaftueshme që të mund të japim një opinion. Deklaratat financiare janë paraqitur sipas ligjit të kontabilitetit dhe udhëzimeve të Ministrisë së Financave.

*“Sipas mendimit tonë, pasi kemi marrë dëshmi të mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit, mbështetur në standardet ISSAI 1700 shprehim një **opinion të kualifikuar**¹ për llogaritë vjetore të Bashkisë Tepelenë dhe fushën e prokurimeve publike, duke arritur në përfundimin se anomali të apo rastet e mospërputhshmërisë, individualisht ose së bashku, janë materiale por jo të përhapura”.*

Opinion i kualifikuar për prokurimet publike.

Objektivi i audituesve në një auditim përputhshmërie është të japë siguri të arsyeshme nëse informacioni i mbledhur sa i takon një çështjeje të veçantë është në përputhje, në të gjitha aspektet materiale, me kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi. Opinionin e dhënë mbi çështjet e fushës së prokurimeve publike e mbështesim në konstatimet se hartimi i kriterëve të dokumenteve standarde të tenderave (në katër raste), nuk është në përputhshmëri me kuadrin rregullator në fuqi, pasi disa kriterë nuk kanë lidhje me objektin dhe natyrën e kontratës. Këto gabime janë materiale. Gjithashtu anomali të e konstatuara në fushën e zbatimit të kontratave të punimeve, për shkak të vlerës së vogël të tyre, nuk janë materiale. Përsa i përket shkallës së përputhshmërisë me kuadrin ligjor në fuqi, të veprimtarisë së komisionit të vlerësimit të ofertave, gabimet e kryera prej këtij komisioni nuk kanë ndikuar në kualifikimin apo s’kualifikimin e pa drejtë të operatorëve ekonomik.“Sipas mendimit tonë, pasi kemi marrë dëshmi të mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit, mbështetur në standardet ISSAI 4100 shprehim një **opinion të kualifikuar**.”

Baza për dhënien e opinionit

Ne kemi përfunduar auditimin e pasqyrave financiare të Bashkisë Tepelenë për vitin 2017 dhe 2018, vlerat e paraqitura në postet e formatit nr.1 -Pasqyra e pozicionit financiar (aktivet dhe pasivet), krahasuar me vlerat e paraqitura në informacionet që jepen në formatet anekse, formati nr.2 -Pasqyra e performancës financiare, (të ardhurat dhe shpenzimet), formati nr.3 -Pasqyra e flukseve monetare (cash floë), Formatit nr.4

-Pasqyra e ndryshimeve në aktivet neto/Fondet neto, Formatit nr.5 -Shënime shpjeguese për hartimin e pasqyrave financiare vjetore, Formatit nr.6 -Pasqyra statistikore e investimeve dhe burimet e financimit, Formatit nr.7/a -Pasqyra gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike), Formatit nr.7/b -Pasqyra gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (vlera neto), Formatit nr.8, Pasqyra statistikore e numrit të punonjësve dhe fondit të pagave.

Gjithashtu është audituar nëse hartimi i kriterëve të dokumenteve standarde të tenderave, vlerësimi i ofertave dhe zbatimi i kontratave të punimeve, janë në përputhshmëri me kriteret e fushës së prokurimeve publike dhe kriteret e kontratave të lidhura.

Nën gjykimin profesional të audituesit, grupi i auditimit ka marrë në konsideratë pragun e materialitetit prej 2% (vlerën 8,153 mijë lekë për shpenzimet).

Përshkrimi i çështjeve:

¹Audituesi duhet të shprehë një opinion të kualifikuar kur ka marrë dëshmi të mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit dhe arrin në përfundimin se anomali të apo rastet e mospërputhshmërisë, individualisht ose së bashku, janë materiale, por jo të përhapura, në llogaritë vjetore apo transaksionet e tjera financiare.

- Vlera e faturave të pa likuiduara gjendje në 30.09.2019, ka vlerën 48,674,646 lekë, nga të cilat detyrime për investime në vlerën 12,220,490 lekë, në 13 raste; detyrime për mallra e shërbime në vlerën 32,435,561 lekë, në 33 raste; detyrime për vendimet gjyqësore të cilat kanë marrë formën e prerë për vlerën 4,018,595 lekë, për 5 raste.

-Në shpenzimet buxhetore ka diferenca midis treguesve të planifikimit dhe zbatimit të buxhetit, më e dukshme kjo në zërin e investimeve publike.

-Efekti real si rezultat i zbatimit të vendimeve gjyqësore për periudhën janar 2017 – shtator 2019 është 5,621,108 lekë, efekt negativ financiar për buxhetin e njësisë vendore.

- Gjendja e llogarisë “Sigurime shoqërore dhe shëndetësore” më 31.12.2017 paraqitet në vlerën 8,981,573 lekë dhe në 31.12.2018 në vlerën 19,907,525 lekë, e cila përfaqëson detyrimet për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore të pa paguara. Gjatë vitit 2019 janë kryer pagesa dhe ky detyrim ka ardhur në ulje. Në datën 30.09.2019 vlera e këtij detyrime është 9,815,896 lekë, ndërsa në datën 20.12.2019, bazuar në dokumentacionin e dërguar nga njësia vendore (urdhër shpenzimet) pas fazës së projekt raportit, ky detyrim ka shkuar në vlerën 7,063,544 lekë. Edhe pse janë marrë masa dhe është ulur konsiderueshëm ky detyrim, anomalia e mos pagesës në kohë të sigurimeve shoqërore është materiale, si në kuptimin e materialitetit sasior edhe atij cilësor.

-Llogaria “Detyrime ndaj shtetit për tatim-taksa”, në 31.12.2019 ka vlerën 3,255,400 lekë dhe përfaqëson detyrime të pa shlyera të bashkisë ndaj buxhetit të shtetit për tatimin mbi pagë të personelit. Përveç kësaj kjo llogari nuk është analizuar sipas klasifikimit kontabël.

-Në llogarinë “Studime dhe kërkime”, nuk është sistemuar vlera prej 10,516,840 lekë që i përkasin 9 raste studime, kërkimeve dhe projekte për investimet e kryera në periudhën para vitit 2018, për objekte të përfunduara në vitet e kaluara, vlerë e cila duhet të ishte sistemuar në llogaritë përkatëse të investimit të përfunduar si pjesë e kostos totale të objektit.

-Llogaria “Toka, troje, terrene” dhe llogaria “Pyje, kullota, plantacione”, nuk paraqesin vlerën e saktë të pasurisë së njësisë vendore, për shkak të mos marrjes së masave për rregjistrimin në ZVRPP të pasurive ekzistuese dhe të atyre të cilat me VKM të posaçme kanë kaluar në pronësi të Bashkisë Tepelenë.

- Në katër procedura prokurimi, një pjesë e kriterëve të veçanta të DST që lidhen me kapacitetin teknik, nuk janë të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, vlerën dhe natyrën e kontratës, si dhe nuk janë argumentuar.

Përgjegjësitë e drejtuesve të njësisë vendore

Drejtimi i njësisë vendore, është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e saktë të pasqyrave financiare në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 9228, datë 29.4.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, me ndryshime dhe kërkesat e tjera në kuadrin e raportimit financiar në fuqi. Drejtimi është gjithashtu përgjegjës për ngritjen dhe monitorimin e sistemit të kontrollit të brendshëm, me qëllim shmangien e gabimeve apo mashtrimet e mundshme. Staf i drejtues është përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare në përputhje me politikën, ligjet dhe rregulloret e miratuara. Personat përgjegjës për drejtimin janë përgjegjës për kontrollin e procesit të raportimit financiar dhe realizimit të të ardhurave nga taksat e tarifave vendore, për përdorimin e burimeve financiare në përputhje me të gjitha ligjet dhe rregulloret në fuqi.

Përgjegjësitë e audituesve të KLSH mbi auditimin

Përgjegjësia e audituesit të KLSH-së është që nëpërmjet auditimit të realizuar të krijojme bindje, të cilat do të shprehen në opinionin e grupit të auditimit mbi saktësinë, vërtetësinë dhe besueshmërinë e ndërtimit të pasqyrave financiare dhe raportimit financiar, nëse pasqyrat financiare janë përgatitur në të gjitha aspektet materiale në përputhje me kuadrin e rregullator të raportimit financiar, si dhe nëse hartimi i kriterëve të DST, vlerësimi i ofertave dhe zbatimi i kontratave të punimeve janë në përputhshmëri me kriteret e fushës së prokurimeve publike dhe kriteret e kontratave të lidhura. Audituesi identifikon çështjet më të rëndësishme lidhur me auditimin e pasqyrave financiare dhe fushave të tjera të auditimit dhe i përshkruan ato në

raportin e auditimit. Siguria që jepet nga audituesi është një siguri e arsyeshme e cila është një nivel i lartë sigurie, por nuk garanton që auditimi i kryer në përputhje me standardet, mundëson identifikimin e çdo gabimi apo anomalie që mund të ekzistojë.

A. MASA ORGANIZATIVE

1. Gjetje nga auditimi: Bashkia Tepelenë nuk ka ngritur si duhet një sistem efektiv të menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm, duke mos hartuar një kuadër të plotë rregullash të shkruara për këtë qëllim. Nuk janë hartuar rregulla për ruajtjen e aktiveve, përfshirë këtu edhe mbrojtjen dhe ruajtjen e të dhënave elektronike (sistem rezervë back-up), rregulla për dorëzimin e detyrës në rastet e largimit të punonjësve nga puna ,nuk është hartuar regjistri i rriskut, lista e proceseve të punës, gjurma e auditimit nga asnjë sektor dhe drejtori. Në fund të çdo viti vlerësimi i funksionimit të sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit nuk është bërë si duhet nga menaxherët kryesor, duke mos përcaktuar pikat e dobëta të këtij sistemi e marrjen e masave për përmirësimin e tij. Nga stafi nuk njihet mjaftueshëm ligji 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, si dhe manuali përkatës në zbatim të këtij ligji.

Njësia e auditit të brendshëm nuk ka kryer auditime në fushat kryesore të veprimtarisë së institucionit, të cilat vlerësohen si fusha me rrisht të lart, të tilla si prokurimet publike, ngritja, implementimi i sistemit të kontrollit të brendshëm dhe efektiviteti i këtij sistemi, inspektorati i mbrojtjes së teritorit, asetet. Gjithashtu nga kjo njësi, në auditimin e kryer prej saj, nuk është bërë ndjekja e rekomandimeve pas 6- muajsh, sipas afatit të përcaktuar në manualin e auditimit.

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 10296 datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, kërkesat e nenit nr.5 dhe nr.6 të ligjit 114/2015, datë 22.10.2015 “ Për auditimin e brendshëm në sektorin publik” (*Më hollësisht trajtuar në pikën A faqe 17-19 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

1.1.Rekomandim:Titullari i njësisë vendore, njësia e auditit të brendshëm dhe menaxherët kryesor të marrin masa për implementimin konkret të kërkesave të kuadrit rregullator për menaxhimin financiar dhe kontrollin në njësinë vendore. Të hartohen rregulla për ruajtjen e aktiveve, duke përfshirë edhe ruajtjen dhe sigurinë e informacionit elektronik, duke siguruar sisteme rezervë të IT (back-up). Të hartohet regjistri i rriskut, gjurma e auditimit dhe lista e proceseve të punës për secilin sektor dhe në nivel institucioni.

1.2.Rekomandim:Nga njësia e auditimit të brendshëm të merren masa për planifikimin në programet e auditimit të fushave kryesore të veprimtarisë së institucionit, të cilat vlerësohen si fusha me rrisht të lart, duke i dhenë mbështetje titullarit të njësisë publike në arritjen e objektivave. Të ndiqet zbatimi brenda afateve të caktuara, i rekomandimeve të dhëna nga KLSH si dhe zbatimi i rekomandimeve të dhëna nga vetë njësia e auditit të brendshëm.

Deri më 31.03.2020

2. Gjetje nga auditimi: Në shpenzimet buxhetore ka diferenca midis treguesve të planifikimit dhe zbatimit të buxhetit. Në vitin 2017 treguesit e buxhetit për shpenzimet nga 637,570 mijë lekë të planifikuara, janë realizuar 515,970 mijë lekë, ose në masën 81%, në vitin 2018 nga 410,952 mijë lekë të planifikuara janë realizuar 389,998 mijë lekë, ose në masën 95%, ndërsa për periudhën janar-shtator 2019 nga 319,323 mijë lekë të planifikuara janë realizuar 228,915 mijë lekë, ose në masën 72%.

Mos realizime të ndjeshme ka në zërin e investimeve, i cili në vitin 2017 është realizuar në masën 68%, në vitin 2018 në masën 90%, ndërsa për periudhën janar-shtator 2019 në masën 31%.

Mos realizimi i treguesve buxhetor në shpenzime ka ardhur si rezultat i mos realizimit të të ardhurave të planifikuara, duke bërë që të planifikohen në buxhet shpenzime të pa mbështetura në pritshmërinë reale të të ardhurave.

Peshën më të madhe të mosrealizimit e zënë investimet në periudhën janar-shtator 2019 të cilat janë realizuar në masën 31% ku ndër të tjera shkak i mosrealizimit është edhe vonesa në kryerjen e procedurave të prokurimit publik.

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, neni 42; 43; 47; 50; 65; UMF nr. 2, datë 06.02.2012 “Për procedurat standarte të zbatimit të Buxhetit”, pikat 253, 354 i ndryshuar me Udhëzimin plotësues nr. 2, datë 10.01.2018 “Për buxhetin e vitit 2018” (Më hollësisht trajtuar në pikën B, faqe 20-25 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

2.1.Rekomandim:Në mënyrë që të mos krijohen diferenca të dukshme midis parashikimit dhe realizimit të buxhetit, Bashkia Tepelenë të marrë masa për hartimin e një buxheti real, mbështetur në realizimin e mundshëm e objektiv të të ardhurave. Të merren në konsideratë realizimet faktike të të ardhurave dhe shpenzimeve në vitin e mëparshëm buxhetor.

Në vijimësi

3. Gjetje nga auditimi: Vlera e faturave të pa likuiduara në 30.09.2019 është **48,674,646 lekë**, nga të cilat detyrime për investime në vlerën 12,220,490 lekë, në 13 raste; detyrime për mallra e shërbime në vlerën 32,435,561 lekë, në 33 raste; detyrime për vendimet gjyqësore të cilat kanë marrë formën e prerë për vlerën 4,018,595 lekë, për 5 raste.

Vlera 48,674,646 lekë është e trashëguar sipas periudhave si më poshtë:

Vlera 9,026,517 e mbartur nga periudha para vitit 2017;

Vlera 6,242,576 është e krijuar gjatë vitit 2017;

Vlera 19,417,869 lekë është e krijuar gjatë vitit 2018;

Vlera 13,987,684 lekë është krijuar gjatë vitit 2019.

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në R.SH”, i ndryshuar, neni 40 “E drejta për të kryer shpenzime”; UMF nr. 5, datë 27.02.2014 “Për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura” ndryshuar me udhëzimin nr. 5/1 datë 21.05.2014;Udhëzimin plotësues nr. 2 të MF, datë 10.01.2018 “Për buxhetin e vitit 2018”, pikat 82-91 “Detyrimet e prapambetura të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore”; UMF nr. 22, datë 30.07.2018 “Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit të njësive të vetëqeverisjes vendore” (Më hollësisht trajtuar në pikën B, faqe 20-25 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

3.1.Rekomandim: Drejtoria e zhvillimit ekonomik dhe menaxhimit financiar, bazuar në Udhëzimin plotësues të Ministrisë Financave nr. 02, datë 10.01.2018 “Për buxhetin e vitit 2018”, pikat 82-91 “Detyrimet e prapambetura të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore” dhe Udhëzimin plotësues të Ministrisë Financave nr. 01, datë 17.01.2019 “Për buxhetin e vitit 2019”, pikat 106-110, “Detyrimet e prapambetura të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore” dhe pikat 116-117-*Raportimi i detyrimeve të prapambetura në njësitë e qeverisjes vendore*’, të paraqesë në mbledhjen e këshillit bashkiak, një material për gjendjen e faturave të pa likuiduara në vite, të hartojë një grafik duke zbatuar të gjitha radhën e pagesave për vlerën 48,674,646 lekë, sipas aneksit bashkangjitur mbi gjendjen e faturave të pa likuiduara me datën 30.09.2019.

Në mbledhjen me të afërt të Këshillit Bashkiak

4. Gjetje nga auditimi: Në pasqyrat financiare, gjendja e llogarisë 435 “Sigurime shoqërore dhe shëndetësore” më 31.12.2017 paraqitet në vlerën 8,981,573 lekë dhe në 31.12.2018 në vlerën 19,907,525 lekë, e cila përfaqëson detyrimet për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore të pa paguara. Gjatë vitit 2019 janë kryer pagesa dhe ky detyrim ka ardhur në ulje. Në datën 30.09.2019 vlera e këtij detyrimi është 9,815,896 lekë, ndërsa në datën 20.12.2019, bazuar në

dokumentacionin e dërguar nga njësia vendore (urdhër shpenzimet) pas fazës së projekt raportit, ky detyrim ka shkuar në vlerën 7,063,544 lekë. Edhe pse janë marrë masa dhe është ulur ky detyrim, anomalia e mos pagesës në kohë të sigurimeve shoqërore është materiale, si në kuptimin e materialitetit sasior edhe atij cilësor.

Vlera e pa likuiduar prej **7,063,544 lekë** i përket periudhave të prapambetura ndër vite si më poshtë vijon:

- detyrime të vitit 2010 në vlerën 1,122,342 lekë, për muajt gusht, shtator, tetor, nëntor, për 35 punonjës;

- detyrime të vitit 2011 në vlerën 1,584,683 lekë për muajt mars, prill, maj, shtator, tetor, nëntor, për 35 punonjës;

- detyrime të vitit 2012 në vlerën 2,454,508 lekë për muajt mars, prill, maj, qershor, gusht, shtator, tetor, nëntor, për 33 punonjës.

- detyrime të vitit 2013 në vlerën 1,902,011 lekë, për muajt shkurt, mars, maj, qershor, gusht, për 46 punonjës.

Të gjitha këto detyrime janë pjesore, pra është likuiduar një pjesë e muajve të mësipërm dhe ka ngelur pa likuiduar pjesa tjetër e detyrimit mujor. Sipas vendimit Nr. 90, datë 20.12.2019, të Këshillit Bashkiak Tepelenë, protokolluar në këtë bashki me nr. 1896/3, datë 23.12.2019, (një kopje e skanuar të cilit është dërguar në KLSH), është vendosur që detyrimet e mësipërme në vlerën 7,063,544 lekë të likuidohen brenda muajit shkurt 2020.

- Gjithashtu nuk është kryer kontabilizimi i plotë sipas nomenklaturës së llogarive të planit kontabël publik, pasi vlera e detyrimit 19,907,525 lekë e nxjerrë në bilanc, nuk është ndarë e analizuar përkatësisht në llogarinë 435 “Sigurime shoqërore”, llogarinë 436 “Sigurime shëndetësore”, si dhe nuk është klasifikuar në: -detyrime të vitit në vazhdim (viti 2018 në vlerën 7,748,651 lekë), detyrime të vitit të mëparshëm (viti 2017 në vlerën 5,039,393 lekë dhe periudha 2010-2013 në vlerën 7,119,481 lekë).

Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr.9136, datë 11.9.2003 i ndryshuar “Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore në Republikën e Shqipërisë”, neni 6 -Detyrimet e personave që paguajnë kontributet, neni 11 -Afatet e deklarimit dhe të pagesës, UMF nr. 08, datë 09.03.2018 “Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njësive të Qeverisjes së Përgjithshme” dhe të VKM nr. 783, datë 22.11.2006 “Për përcaktimi i standardeve dhe të rregullave kontabël”; pika 1. Përcaktimin e standardeve dhe të rregullave kontabël, me cilësinë e sistemit kontabël të përgjithshëm, sipas tekstit, që i bashkëlidhet këtij vendimi, standardet dhe rregullat kontabël, kapitulli IV, llogaritë e të tretëve, klasa 4 (*Më hollësisht trajtuar në pikën C, faqe 42-52 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*)

4.1.Rekomandim: Titullari i njësive vendore dhe Drejtoria e zhvillimit ekonomik dhe menaxhimit financiar, të marrin masa të menjëhershme pagesën e detyrimeve të prapambetura për sigurime shoqërore dhe shëndetësore në vlerën **7,063,544 lekë**.

Drejtoria e zhvillimit ekonomik dhe menaxhimit financiar, të marrë masa për zbatimin e procedurave ligjore për klasifikimin kontabël të llogarisë 435 “Sigurime shoqërore dhe shëndetësore”.

Brenda muajit shkurt 2020

5. Gjetje nga auditimi: Në pasqyrat financiare, gjendja e llogarisë 423,429 “Personeli, paradhënie, deficite, gjoba”, në fund të vitit 2018 paraqitet e pa ndryshuar në vlerën 1,254,774 lekë, e cila përfaqëson detyrimet e punonjësve për tatimin mbi pagë për vitin 2018 dhe të trashëguar ndër vite. Konstatohet se, vlera totale 1,254,774 lekë nuk është analizuar sipas klasifikimit kontabël përkatësisht: në detyrime të vitit në vazhdim 2018 në vlerën 351,466 lekë, në detyrime të viteve të mëparshme për vitet 2010-2013 në vlerën 903,308 lekë, të trashëguara dhe të pa arkëtuara nga punonjësit si dhe nuk është arkëtuar nga punonjësit vlera 1,254,774 lekë

dhe nuk është derdhur për llogari buxhetit të shtetit se detyrim për tatimin mbi pagë, veprimi dhe mosveprimi është në kundërshtim me kërkesat e UMF nr. 08, datë 09.03.2018 “Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit e të pasqyrave financiare vjetore të njësive të Qeverisjes së Përgjithshme” dhe VKM nr. 783, datë 22.11.2006 “ Për përcaktimi i standardeve dhe të rregullave kontabël”; pika 1. Përcaktimin e standardeve dhe të rregullave kontabël, me cilësinë e sistemit kontabël të përgjithshëm, sipas tekstit, që i bashkëlidhet këtij vendimi, standardet dhe rregullat kontabël, kapitulli IV, llogaritë e të tretëve, klasa 4 (Më hollësisht trajtuar në pikën C, faqe 42-52 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

5.1.Rekomandim:Drejtoria e zhvillimit ekonomik dhe menaxhimit financiar, të marrë masa për zbatimin e procedurave ligjore për klasifikimin kontabël të llogarisë 423,429 “Personeli, paradhënie, deficite, gjoba” dhe të pagesës së detyrimeve të prapambetura të punonjësve për tatimin mbi pagë për vitin 2018 dhe të trashëguar ndër vite në vlerën 1,254,774 lekë.

Në hartimin e pasqyrave financiare të vitit 2020

6. Gjetje nga auditimi: Në pasqyrat financiare, gjendja e llogarisë 202 “Studime dhe kërkime” në fund të vitit 2018, paraqitet në vlerën 10,516,840 lekë, e cila përfaqëson vlerat e 9 projekteve për objekte të cilat kanë përfunduar punimet dhe janë marrë në dorëzim nga njësia vendore, (sipas aneksit në fund të raportit) , vlerë e cila duhet të ishte sistemuar në llogaritë përkatëse të investimit të përfunduar, si pjesë e kostos totale të objektit. Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kërkesat e UMF nr. 08, datë 09.03.2018 “Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit e të pasqyrave financiare vjetore të njësive të Qeverisjes së Përgjithshme”; UKM nr. 2, datë 08.05.2003 “Për klasifikimin dhe strukturën e kostos së punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar, pika c, nën pika b (Më hollësisht trajtuar në pikën C, faqe 42-52 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

6.1.Rekomandim:Drejtoria e zhvillimit ekonomik dhe menaxhimit financiar, të marrë masa për sistemimin e llogarisë 202 “Studime dhe kërkime”, duke bërë që në këtë llogari të paraqitet vetëm vlera e projekteve, për të cilat investimet e lidhura me to nuk kanë përfunduar. Kjo llogari të zvogëlohet për vlerën **10,516,840 lekë** dhe kjo vlerë të shtohet në investimet e përfunduara sipas objekteve që u përkasin projektet.

Në hartimin e pasqyrave financiare të vitit 2020

7. Gjetje nga auditimi: Në pasqyrat e pozicionit financiar, llogaria 210 “Toka, troje, terrene” dhe llogaria nr. 211 “Pyje, kullota, plantacione”, nuk paraqesin vlerën e saktë të pasurisë së njësive vendore, për shkak të mos marrjes së masave për regjistrimin në ZVRPP të pasurive ekzistuese dhe të atyre të cilat me VKM të posaçme kanë kaluar në pronësi të Bashkisë Tepelenë. Në vitin 2018 llogaria 210 “Toka, troje, terrene” ka vlerën 7,778,488 lekë dhe përbëhet nga vlera 250,910 lekë për parqe dhe lulishte, vlera 2,879,803 lekë për rehabilitim ambiente publike, vlera 3,279,917 lekë për sistemime të ambienteve publike, vlera 1,367,858 lekë për kënde lojërash për fëmijë. Llogaria nr. 211 “Pyje, kullota, plantacione” në fund të vitit 2018 ka vlerën 96,200 lekë dhe paraqet vlerën e pemëve dekorative.

Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 25/2018, datë 10.05.2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare, neni 15, pika 1 dhe 2, të UMF nr. 30, datë 27.12.2011“Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, kapitulli IV. pika 74 dhe 96 dhe të UMF nr. 8 datë 9.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme” (Më hollësisht trajtuar në pikën C, faqe 42-52 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

7.1.Rekomandim: Titullari i njësive vendore, Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik dhe Menaxhimit Financiar, të marrë masa për sistemimin e llogarisë 210 “Toka, Troje, Terrene” dhe llogarisë nr. 211 “Pyje, kullota, plantacione, duke bërë që në këto llogari të paraqitet vlera e saktë e pasurisë së njësive vendore. Të inventarizohen këto prona, duke krijuar regjistrin e aktiveve me të gjitha

të dhënat e nevojshme (vendndodhje, sipërfaqja etj.). Të merren masa për rregjistrimin e këtyre aseteve në Agjensinë Shtetërore të Kadastrës.

Deri më 31.03.2020

8. Gjetje nga auditimi: Në pasqyrat e pozicionit financiar, gjendja e llogarisë 431 “Detyrime ndaj shtetit për tatim-taksa”, në 31.12.2018 paraqitet në vlerën 3,255,400 lekë, e cila përfaqëson detyrime të pa paguar të bashkisë ndaj buxhetit të shtetit për tatimin mbi pagë të personelit, e analizuar si më poshtë:

- vlera 351,466 lekë, dhjetor viti 2018
- vlera 1,283,450 lekë, janar-dhjetor viti 2013(pjesërisht)
- vlera 917,708 lekë, janar-dhjetor viti 2012 (pjesërisht)
- vlera 562,436 lekë, mars-dhjetor viti 2011(pjesërisht)
- vlera 140,340 lekë, gusht-nëntor viti 2010.(pjesërisht).

Vlera 3,255,400 lekë nuk është analizuar sipas klasifikimit kontabël përkatësisht: -detyrime të vitit në vazhdim 2018 në vlerën 351,466 lekë, -detyrime të viteve të mëparshme për vitet 2010-2013 në vlerën 2,903,934 lekë, të trashëguara dhe të pa derdhura në llogari të buxhetit të shtetit.

Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr.9136, datë 11.9.2003 i ndryshuar “ Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore në Republikën e Shqipërisë”, neni 6 -Detyrimet e personave që paguajnë kontributet, neni 11 -Afatet e deklarimit dhe të pagesës; UMF nr.8, datë 09.03.2018 “Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njësive të Qeverisjes së Përgjithshme”; VKM nr. 783, datë 22.11.2006 “Për përcaktimin e standardeve dhe të rregullave kontabël”; pika 1- Përcaktimin e standardeve dhe të rregullave kontabël, me cilësinë e sistemit kontabël të përgjithshëm, sipas tekstit, që i bashkëlidhet këtij vendimi, standardet dhe rregullat kontabël, kapitulli IV, llogaritë e të tretëve, klasa 4 (*Më hollësisht trajtuar në pikën C, faqe 42-52 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

8.1.Rekomandim: Titullari i njësisë vendore dhe Drejtoria e zhvillimit ekonomik dhe menaxhimit financiar, të marrin masa të menjëhershme për pagesën e detyrimeve të prapambetura në vlerën 3,255,400 lekë për tatimin mbi pagë të personelit, si dhe për zbatimin e procedurave ligjore për klasifikimin kontabël të llogarisë 431 “Detyrime ndaj shtetit për tatim-taksa”.

Brenda muajit shkurt 2019

9. Gjetje nga auditimi: Në katër procedura prokurimi, një pjesë e kriterëve të veçanta të DST që lidhen me kapacitetin teknik, nuk janë të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, vlerën dhe natyrën e kontratës, si dhe nuk janë argumentuar. Në raste të veçanta nuk janë përcaktuar dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët. Procedura në të cilat janë konstatuar shkeljet e mësipërme janë:1)"Sistemim asfaltim rruga Pasarelë – Dragot (loti I), me vlerë të fondit limit 46,796,083 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 15.09.2017; 2) "Rehabilitim kanali ujitës Gusmar”, me vlerë të fondit limit 16,906,652 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 18.11.2017; 3) “Rikonstruksion i kanalit ujitës në fshatrat Koder-Lekel”, me vlerë të fondit limit 11,427,499 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 08.03.2017; 4), “Rikonstruksion i kanalit ujitës në fshatin Luzat”, me vlerë të fondit limit 9,245,280 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 08.03.2017. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kërkesat e VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, sipas neneve të mëposhtëm:

- neni 26- Kontratat për punë publike, pika nr. 5;
- nenin 61, pika nr.2 (*Më hollësisht trajtuar në pikën D1, faqe 52-60 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

9.1.Rekomandim: Në hartimin e kriterëve të DST, njësia e prokurimit të jap argumente për secilin kriter dhe këto argumente të bëhen pjesë e procesverbalit që mbahet prej saj.

Argumentimi të bëhet duke u mbështetur në preventivin e punimeve, volumin dhe afatin e punimeve, etj.

Në vijimësi

10. Gjetje nga auditimi: Nga autoriteti kontraktor Bashkia Tepelenë, nuk janë marrë masa për trajnimin e zyrtarëve të përfshirë në veprimtarinë e prokurimit publik (personave të cilët janë caktuar të kryejnë detyrën e anëtarit të komisionit të vlerësimit të ofertave dhe anëtarit të njësisë së prokurimit. Njësia vendore nuk ka paraqitur asnjë kërkesë pranë APP për trajnimin e tyre, duke mos garantuar se këta punonjës kanë aftësitë dhe përgatitjen e duhur në drejtim të njohjes së bazës ligjore në fushës e prokurimit publik, për kryerjen e detyrës së ngarkuar. Kryerja e trajnimeve është një domosdoshmëri për anëtarët e komisionit të vlerësimit të ofertave dhe anëtarit të njësisë së prokurimit, si dhe çdo komisioni tjetër që ngrihet për kryerjen e detyrave që i ngarkohen nga titullari, pasi nëpërmjet tyre ulen rrisqet e kryerjes së gabimeve. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kërkesat e VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 83 (*Më hollësisht trajtuar në pikën D1, faqe 52-60 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

10.1.Rekomandim: Titullari i njësisë vendore dhe njësia e burimeve njerëzore, të marrin masa për trajnimin e zyrtarëve të përfshirë në veprimtarinë e prokurimit publik, duke paraqitur në çdo fillim viti pranë APP, kërkesë për trajnimin e punonjësve të cilët do të jenë të angazhuar si anëtar të KVO dhe NJP.

Në vijimësi

11. Gjetje nga auditimi: Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion nga institucioni Qendra Kombëtare e Biznesit (QKB), nëpërmjet njësisë vendore, konstatohet se numri i subjekteve të regjistruara në QKB dhe me status aktiv, që zhvillojnë aktivitet në teritorin e Bashkisë Tepelenë, është 619, nga të cilat 155 subjekte të kategorisë person juridik dhe 464 subjekte të kategorisë person fizik. Por nga dokumentacioni që u paraqit nga zyra e taksave dhe tarifave vendore, konstatohet se numri i subjekteve të regjistruara në njësinë vendore, për të cilat llogariten taksa dhe tarifa, është 412, nga të cilat 87 subjekte të kategorisë person juridik dhe 325 subjekte të kategorisë person fizik, pra 207 subjekte më pak. Nga zyra e taksave dhe tarifave vendore jepen shpjegime se diferenca vjen si rezultat i mbylljes së këtyre subjekteve dhe mos kryerjes prej tyre të deklarimeve dhe azhurnimeve në organet tatimore dhe QKB. Ky mos rakordim nuk jep siguri se numri i bizneseve të regjistruar në njësinë vendore për pagesën e taksave dhe tarifave vendore është i saktë. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me nenin 40, të ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, neni 40 - Regjistrimi i personave që ushtrojnë veprimtari tregtare dhe jo tregtare, pika 4- Regjistrimi në Qendrën Kombëtare të Biznesit shërben njëkohësisht si regjistrim në administratën tatimore (*Më hollësisht trajtuar në pikën B2, faqe 25-42 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

11.1.Rekomandim: Me qëllim evidentimin e saktë të numrit të bizneseve që kryejnë aktivitet në Bashkinë Tepelenë, drejtoria ekonomike, zyra e taksave dhe tarifave vendore, të verifikojnë në teren numrin e bizneseve faktik që ushtrojnë aktivitet, si dhe të bashkëpunojnë me drejtorinë rajonale Tatimore Gjirokastër dhe QKB për të evidentuar subjektet e mbyllura, që nuk ushtrojnë aktivitet e nuk kanë bërë deklarin për këtë qëllim. Në fund të verifikimeve dhe rakordimeve të bëhen ndryshimet e nevojshme në regjistrin e taksapaguesve privat në Bashkinë Tepelenë. Çdo ndryshim të justifikohet me dokumentacion përkatës.

Në vijimësi

12.Gjetje nga auditimi: Nga dokumentacioni i paraqitur nga zyra e taksave dhe tarifave vendore konstatohet se në Bashkinë Tepelenë në vitin 2019 kanë zhvilluar aktivitet 32 subjekte pa u regjistruar në QKB. Mos regjistrimi i subjekteve në QKB, ka sjellë mos regjistrimin e tyre

në organet tatimore, e për pasojë mos pagesën e detyrimeve shoqërore dhe shëndetësore, si dhe TAP, por edhe dëmtim e vetë individëve, të cilët nuk vlerësojnë interesat e tyre afatgjata, që sjellë vetëdeklarimi dhe regjistrimi në skemën e sigurimeve. Nga drejtoria e taksave dhe tarifave vendore Bashkia Tepelenë nuk janë marrë masa për mbyllje të veprimtarisë së këtyre subjekteve dhe konfiskim të mallit si dhe nuk është vendosur asnjë gjobë ndaj tyre, në kundërshtim me nenin 41-Identifikimi i personave, që ushtrojnë veprimtari tregtare pa u regjistruar në nenit 112 -Mungesa e ekzekutimit të detyrimit për regjistrim, të ligjit nr. 9920 "Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, pikën 6 dhe 7 të paragrafit III të VKM 77, datë 28.01.2015 "Për kontributet e detyrueshme dhe përfitimet nga sistemi i sigurimeve shoqërore dhe sigurimi i kujdesit shëndetësor", i ndryshuar (*Më hollësisht trajtuar në pikën B.2, faqe 25-42 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

12.1. Rekomandim: Sektori i taksave dhe tarifave vendore, për subjektet e paregjistruara në QKR të njoftojnë zyrtarisht Drejtorinë Rajonale Tatimore Gjirokastrë dhe QKB për marrjen e masave për futjen e tyre në sistemin e deklarimit. Në rastet e konstatimit të subjekteve që zhvillojnë aktivitet në territorin e njësisë vendore pa u regjistruar, të marrë të gjitha masa për mos lejimin e tyre, duke vendosur sanksione e llogaritur detyrimet tatimore edhe për periudhën e pa regjistruar, me qëllimin final që subjektet të kryejnë regjistrimin e tyre në QKB.

Në vijimësi

13. Gjetje nga auditimi: Bashkia Tepelenë është audituar nga KLSH në vitin 2016 dhe në vijim është bërë verifikimi i zbatimit të rekomandimeve të dërguara në Bashkinë Tepelenë nga KLSH. Me shkresën nr. 1113/122, datë 1153/40 është rikërkuar zbatimi i masave të pa zbatuara. Për përmirësimin e gjendjes janë rikërkuar 11 masa organizative, nga të cilat janë pranuar plotësisht 11 masa, janë zbatuar 10 dhe 1 masë e pa zbatuar.

Nga 25 masa për shpërblim dëmi, në vlerën 63,988,000 lekë, të cilat janë pranuar dhe kontabilizuar, deri me datë 30.09.2019 janë arkëtuar 1,619,316 lekë, ndërsa shuma 62,368,684 lekë nuk është arkëtuar.

Nga 25 masat e mësipërme, për 19 prej tyre në vlerën 9,106,270 lekë janë nxjerrë urdhrat e titullarit për zbatim, por nuk janë kryer veprime të mëtejshme për arkëtim, 5 masa për shpërblim dëmi në vlerën 46,209,883 lekë janë në proces gjyqësor dhe 1 masë shpërblim dëmi në vlerën 5,917,096 lekë, që i përket arkëtimit për detyrimet e taksave dhe tarifave vendore, nga njësia vendore janë nxjerrë urdhrat e bllokimit për llogaritë bankare, hipotekë dhe drejtorinë e transportit rrugor, por ende e pa arkëtuar.

-Për 11 masa administrative, nuk janë zbatuar penalitetet e vendosura nga APP mbi shkeljet e konstatuara në procedurat e prokurimeve në vlerën totale prej 1,900,000 lekë.

- Në lidhje me njoftimin e Komisionit të Licencave, pranë Ministrisë të Zhvillimit Urban për heqjen e licensave për dy subjekte: -R. S. (në cilësinë e përfaqësuesit ligjor të firmës "I.K." Shpk; - Ing. Gj.M. (në cilësinë e mbikëqyrësit të punimeve), nuk është bërë njoftimi nga ana e IMTV (*Më hollësisht trajtuar në pikën E faqe 72-78 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

13.1 Rekomandim Nga Kryetari i Bashkia Tepelenë, drejtoria juridike dhe ekonomike të merren masa të menjëhershme për zbatimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH në auditimin e mëparshëm. Për këtë të ndiqen të gjitha rrugët e mundshme ligjore deri në hapjen e proceseve gjyqësore. Nga titullari të hartohet një plan veprimi dhe të caktohen personat përgjegjës për zbatimin e tij. Të njoftohet KLSH për masat e marra.

Deri më 31.03.2020

B. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI

Bazuar në ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit” neni 15 germa (b) dhe (c) –*Të drejtat e KLSH dhe mbështetur në nenet 98-102, të ligjit nr. 44/2015, datë 30.04.2015 “Kodi i procedurave administrative në Republikën e Shqipërisë”, nenet 21-33, të ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore” dhe pikën 93, të udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitet e sektorit publik”, nga Titullari i Njesisë Publike, të nxirren aktet administrative përkatëse dhe të kërkohet në rrugë ligjore (Padi gjyqësore), duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit, me qëllim kërkimin për shpërblimin e dëmit. **Nëpunësi zbatues** të ndjekë procesin dhe të kryej regjistrimet e nevojshme kontabël përfundimtare, me qëllim shpërblimin e dëmit në vlerën **2,404,479 lekë**, si më poshtë:*

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të punimeve civile të kontratës me objekt “*Rikonstruksion i Rrugës “Ago Celi”, Rrugës së re dhe Rikonceptim i palestrës të lagjes “15 Shtatori”, Bashkia Tepelenë*”, me vlerë të kontratës 140,470,869 lekë me TVSH, shpallur fitues operatori ekonomikë “G.C.” SHPK, rezultoi se nuk janë realizuar zërat e punimeve: “FV Rrjetë plegmë Ø 6 mm çdo 20 cm për trotuarët”; “Punime ndërtimi për trotuarin” duke shkaktuar një dëm ekonomik në vlerën **390,280 lekë pa TVSH**. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve me nr. 1/1 Prot, datë 10.02.2017, të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkisë Tepelenë dhe sipërmarrësit Operatorit Ekonomikë “G. C” SHPK”. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve me nr. 1/1 Prot, datë 10.02.2017, të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkisë Tepelenë dhe sipërmarrësit Operatorit Ekonomikë “G. C. SHPK” (*Më hollësisht trajtuar në pikën D2 faqe 60-72 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

1.1. Rekomandim: Nga Bashkia Tepelenë, të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **390,280 lekë pa TVSH** nga OE “G. C.” SHPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 1/1 Prot, datë 10.02.2017, për kryerjen e punimeve me objekt “*Rikonstruksion i Rrugës “Ago Celi”, Rrugës së re dhe Rikonceptim i palestrës të lagjes “15 Shtatori”, Bashkia Tepelenë*”, vlerë kjo e cila përfaqëson një dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore.

Deri më 31.03.2020

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të punimeve civile të kontratës me objekt “*Rikonstruksion i kanalit ujitës në fshatin Luzat NjA Qendër*”, Bashkia Tepelenë, me vlerë të kontratës bazë 8,686,074 lekë me TVSH dhe shtesës së kontratës me vlerë 1,736,979 lekë me TVSH, shpallur fitues operatori ekonomikë “A.” SHPK, rezultoi se nuk janë realizuar zërat e punimeve: “Germim shkëmbi”; “Gërmim kanalesh në tokë të fortë, me krahë, me seksion 0.75 m²”; “Germim tokë e zakonshme”; “Mure betoni C 12/15” dhe “Hidroizolim tubacion dy duar bitum” të kontratës bazë dhe zëri “Veshje me beton C 16/20” që i përket shtesës së kontratës, duke shkaktuar një dëm ekonomik në vlerën **825,098 lekë pa TVSH**. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën bazë me nr. 46/1 Prot, datë 06.04.2017 dhe shtesës së kontratës me nr. 46/2 Prot, datë 07.06.2017, të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkisë Tepelenë dhe sipërmarrësit Operatorit Ekonomikë “A.” SHPK (*Më hollësisht trajtuar në pikën D2 faqe 60-72 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

2.1. Rekomandim: Nga Bashkia Tepelenë, të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **825,098 lekë pa TVSH** nga OE “A.” SHPK, në cilësinë e sipërmarrësit të kontratës bazë me nr. 46/1 Prot., datë 06.04.2017 dhe shtesës së kontratës me nr. 46/2 Prot., datë 07.06.2017, për kryerjen e punimeve me objekt “*Rikonstruksion i kanalit ujitës në fshatin Luzat NjA Qender*”, Bashkia Tepelenë, vlerë kjo e cila përfaqëson një dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore.

Deri më 31.03.2020

3. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të punimeve civile të kontratës me objekt “Rikonstruksion i qendrës së fshatit Veliqot”, Bashkia Tepelenë, me vlerë të kontratës 4,657,095 shpallur fitues operatori ekonomikë “A.” SHPK, rezultoi se nuk janë realizuar zërat e punimeve: “Prishje shtresash”; “Spërkatje me emulsion bituminoz 0.5 l/m²”; “Shtresë binderi me granil gur kave 6 cm me makineri”; “Shtresë asfaltobetoni me granil gur kave, 4 cm, me makineri”, duke shkaktuar një dëm ekonomik në vlerën **456,518 lekë pa TVSH**. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën bazë me nr. 77/3 Prot, datë 13.06.2017, të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkisë Tepelenë dhe sipërmarrësit Operatorit Ekonomikë “A.” SHPK (Më hollësisht trajtuar në pikën D2 faqe 60-72 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

3.1. Rekomandim: Nga Bashkia Tepelenë, të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **456,518 lekë pa TVSH** nga Operatori Ekonomikë “A.” SHPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 77/3 Prot, datë 13.06.2017 me objekt “Rikonstruksion i qendrës së fshatit Veliqot”, Bashkia Tepelenë, vlerë kjo e cila përfaqëson dëm ekonomik në buxhetin e njësisë vendore, si rrjedhojë e situacionimit të punimeve të pakryera.

Deri më 31.03.2020

4. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të punimeve civile të kontratës me objekt “Rikonstruksioni i bllokut midis rrugës Tafil Buzi dhe rrugës Bilbilenjtë”, me vlerë të kontratës 4,152,691 lekë pa TVSH, shpallur fitues operatori ekonomikë “Sh.” SHPK, rezultuan diferenca midis volumeve të punimeve të situacionuara e likuiduara dhe volumeve të punimeve të kryera në fakt, në vlerën **149,488 lekë pa TVSH**, dëm ekonomik për buxhetin e shtetit dhe të njësisë vendore. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve Nr. 38/1 prot., datë 18.05.2018 të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkia Tepelenë dhe OE “Sh.” SHPK (Më hollësisht trajtuar në pikën D2 faqe 60-72 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

4.1. Rekomandim: Nga Bashkia Tepelenë të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **149,488 lekë pa TVSH** nga OE “Sh.” SHPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me Nr. 38/1 prot datë 18.05.2018, me objekt “Rikonstruksioni i bllokut midis rrugës Tafil Buzi dhe rrugës Bilbilenjtë”, Bashkia Tepelenë, vlerë që përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si pasojë e likuidimit të punimeve të pakryera.

Deri më 31.03.2020

5. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të punimeve civile të kontratës me objekt “Sistemim Asfaltim rruga Pasarelë – Dragot, Loti I”, Bashkia Tepelenë, me vlerë të kontratës 46,784,793 lekë pa TVSH, shpallur fitues operatori ekonomikë “C.R.” SHPK, rezultuan diferenca midis volumeve të punimeve të situacionuara e likuiduara dhe volumeve të punimeve të kryera në fakt, në vlerën **225,831 lekë pa TVSH**. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve Nr. 131/1 prot datë 03.10.2017 të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkia Tepelenë dhe OE “C. R.” SHPK (Më hollësisht trajtuar në pikën D2 faqe 60-72 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

5.1. Rekomandim: Nga Bashkia Tepelenë të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **225,831 lekë pa TVSH** nga OE “C. R.” SHPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me Nr. 131/1 prot datë 03.10.2017, me objekt “Sistemim Asfaltim rruga Pasarelë – Dragot, Loti I”, Bashkia Tepelenë, vlerë që përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si pasojë e likuidimit të punimeve të pakryera.

Deri më 31.03.2020

6. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të punimeve civile të kontratës me objekt “Rehabilitim i kanalit ujitës Gusmar”, Bashkia Tepelenë, me vlerë të kontratës 16,899,033 lekë

pa TVSH, shpallur fitues operatori ekonomikë “Sh.” SHPK, rezultuan diferenca midis volumeve të punimeve të situacionuara e likuiduara dhe volumeve të punimeve të kryera në fakt, në vlerën **357,264 lekë pa TVSH**. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve pa nr. prot datë 04.12.2017 të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkia Tepelenë dhe OE “Sh.” SHPK (*Më hollësisht trajtuar në pikën D2 faqe 60-72 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

6.1. Rekomandim: Nga Bashkia Tepelenë të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **357,264 lekë pa TVSH** nga OE “Sh.” SHPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën pa nr. prot datë 04.12.2017, me objekt “Rehabilitim i kanalit ujitës Gusmar”, Bashkia Tepelenë, vlerë që përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si pasojë e likuidimit të punimeve të pakryera.

Deri më 31.03.2020

B.1 MASA PËR ELIMINIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE NË ADMINISTRIMIN E FONDEVE PUBLIKE

1. Gjetje nga auditimi: Bashkia Tepelenë për periudhën objekt auditimi ka administruar për zbatim 7 vendime gjyqësore të formës së prerë (të mbartura dhe gjatë periudhës së auditimit) në vlerën 6,270,288 lekë, efekt negativ në buxhetin e njësisë vendore. Nga vendimet e mësipërme tre raste janë për “Dëmshpërblim për largim të padrejtë nga puna”, në vlerën 2,812,560 lekë, katër raste për “detyrim kontrate” në vlerën 3,454,728 lekë, janë shtuar gjatë periudhës vlera 3,369,415 lekë, janë zbatuar (likuiduar) në vlerën 5,621,108 lekë, përkatësisht në vitin 2017 vlera 2,173,493, lekë, në vitin 2018 vlera 2,977,615 lekë dhe në vitin 2019 vlera 470,000 lekë, pra efekti real si rezultat i zbatimit të vendimeve gjyqësore për periudhën janar 2017 – shtator 2019 është **5,621,108 lekë, efekt negativ financiar për buxhetin e njësisë vendore**. Mbeten për likuidim të mëtejshëm në buxhetin e vitit 2019, e në vijim vlera 4,018,595 lekë, zbatimi i vendimeve të mësipërme do të rëndoj shpenzimet e viteve në vazhdim. Përpara zbatimit të vendimeve gjyqësore nga titullari nuk janë nxjerrë përgjegjësitë administrative dhe nuk është nxjerrë akti që provon gjurmën e auditimit të këtij procesi, në kundërshtim me pikën 62 të UMF nr.2, datë 06.02.2012 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit” (*Më hollësisht trajtuar në pikën B.1, faqe 20-25 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*)

1.1. Rekomandim: Titullar i njësisë vendore të analizojë të gjitha rastet e vendimeve gjyqësore, të nxjerr arsyet dhe përgjegjësitë për efektin negativ që këto vendime kanë dhënë në buxhetin e njësisë vendore, ndërsa sektori juridik të ndjek proceset në të gjitha shkallët e gjykimit, duke bërë edhe rekurs. Në rastet e largimeve të punonjësve nga puna, nga sektori juridik dhe titullari të zbatohen të gjitha procedurat e nevojshme të afateve të njoftimit dhe të pagesave të duhura, me qëllim që të ulen rrisqet e humbjes së proceseve gjyqësore. Përpara zbatimit të vendimit gjyqësor Titullari të nxjerr përgjegjësitë administrative, si dhe aktin që provon gjurmën e auditimit të këtij procesi.

Brenda muajit shkurt 2020

B.2. MASA PËR ULJEN E BORXHIT TATIMOR PËR TË RRRITUR PERFORMANCËN NË ARKËTIMIN E DETYRIMEVE PËR TATIM TAKSAT VENDORE, PËRFSHIRË DHE DETYRIMET NGA QIRADHËNIA (TË ARDHURA TË MUNGUARA)

1. Gjetje nga auditimi: Nga puna e pa mjaftueshme e Sektorit të Taksave dhe Tarifave Vendore në Bashkinë Tepelenë, në fund të vitit 2019 janë krijuar debitorë për taksat dhe tarifa vendore në vlerën totale **12,618,921 lekë**. Kjo vlerë përbëhet nga detyrimi prej 11,263,917 lekë nga subjektet private (principal 9,410,242 lekë, kamatëvonesë 1,826,675 lekë), si dhe detyrimi prej 1,355,004 lekë nga 953 subjekte familjare, sipas rakordimit që njëzia vendore ka me “Ujësjiellësin Tepelenë” SHA. Vlera debitorë e taksapaguesve privat është e ndarë si më poshtë:

- për vitin 2017 vlera e debisë 2,739,025 lekë, nga e cila principali 2,212,959 lekë, kamat vonesa 526,066 lekë, numri subjekteve debitor 112, nga të cilat 16 subjekte biznesi i madh dhe 96 subjekte biznesi i vogël;

- për vitin 2018 vlera e debisë 3,987,683, nga e cila principali 3,268,040 lekë, kamat vonesa 719,643 lekë, numri subjekteve debitor 143 nga të cilat 31 subjekte biznesi i madh dhe 112 subjekte biznesi i vogël;

- për vitin 2019 vlera e debisë 4,537,209 lekë, nga e cila principali 3,722,074 lekë, kamat vonesa 815,135 lekë, numri subjekteve debitor 205, nga të cilat 32 subjekte biznesi i madh dhe 173 subjekte biznesi i vogël.

Nga zyra e Taksave dhe Tarifave Vendore nuk janë ndjekur të gjithë procedurat e nevojshme ligjore, për arkëtimin e debitorëve veprim në kundërshtim me nenin 4, 26, 32, 34, të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, nenet 91, të ligjit nr. 9920 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, dhe nenin 12 të Udhëzimit të Ministrisë Financave nr. 24, datë 02.09.2008, Kreu i XI-Mbledhja me forcë e detyrimeve tatimore (*Më hollësisht trajtuar në pikën B2, faqe 27-42 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

1.1. Rekomandim: Drejtoria ekonomike, zyra e taksave dhe tarifave vendore, bazuar në nenin 70 pika 3 “E drejta për të nxjerrë njoftimin e vlerësimit tatimor”, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, *për të gjitha subjektet e private* për vlerën e detyrimit prej **11,263,917 lekë** të nxjerrë njoftim vlerësimet tatimore dhe në vazhdim të marren masat për arkëtimin e këtij detyrimi, duke ndjekur rrugët e mëposhtme:

a- Tu dërgohen të gjitha bankave të nivelit të dytë urdhrat e bllokimit të llogarive bankare, bazuar në nenin 90, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008.

b- Tu dërgohen Drejtorisë Rajonale të Transportit, si dhe Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, kërkesat për vendosjen e barrës siguroese respektivisht për mjetet dhe për pasuritë e paluajtshme, bazuar në nenin 91 të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”.

c- Në rast se bizneset private edhe pas njoftimeve zyrtare dhe dërgimit të urdhër bllokimeve në bankë, nuk kryejnë pagesën e detyrimeve, bazuar në nenin 182, të ligjit të Kodit Penal në RSH i ndryshuar, pasi të vendosen masa administrative apo sekuestro, të bëhet kallëzim penal.

d- Për debitorët e kategorisë familjare bazuar në akt-marrëveshjen e lidhur me “Ujësjiellës” ShA, të kërkojë nga kjo e fundit në cilësinë e agentit tatimor, të marrë masa për arkëtimin e detyrimit prej 1,355,004 lekë nga 953 subjekte familjare (*Më hollësisht trajtuar në pikën B2 faqe 25-42 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Deri më 31.03.2020

2. Gjetje nga auditimi: Nga drejtoria e planifikimit, zhvillimit dhe kontrollit të territorit dhe sektori i taksave dhe tarifave vendore, Bashkia Tepelenë, nuk është llogaritur saktë taksa e ndikimit në infrastrukturë për ndërtimet e reja, nuk është kryer përlllogaritja në bazë të çmimit referencë që është kosto mesatare e ndërtimit sipas Entit Kombëtar të Banesave, me pasojë të **ardhura të munguara për buxhetin e njësisë vendore në vlerën 7,429,682 lekë**. Kjo vlerë është detyrim nga tre pronarët e lejeve të ndërtimit si më poshtë:

- z. Xh. N. në vlerën 43,920 lekë, leje ndërtimi në vitin 2017;
- z. R. T. në vlerën 782,818 lekë, leje ndërtimi në vitin 2018;
- z. I.H. dhe B. H. në vlerën 6,603,574 lekë leje ndërtimi në vitin 2019.

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me ligjin nr. nr. 107, datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, të ndryshuar, neni 46, Udhëzimin e KM nr.4, datë 30.9.2015 “Për miratimin e kostos mesatare të ndërtimit të banesave nga Enti Kombëtar i banesave, për vitin 2015”, Udhëzimin KM nr.3, datë 28.12.2016, “Për miratimin e kostos mesatare të ndërtimit të banesave nga Enti Kombëtar i banesave, për vitin 2016”, VKB nr.2, datë 20.01.2017, nr.41, datë 21.12.2017 dhe nr.74, datë 28.12.2018 “Për miratimin e Paketës Fiskale të Bashkisë Tepelenë” (*Më hollësisht trajtuar në pikën B2 faqe 25-42 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

2.1.Rekomandim: Nga titullari i njësisë vendore, drejtoria e zhvillimit ekonomik dhe menaxhimit financiar, zyra e taksave vendore, të merren të gjitha masat e duhura ligjore, për arkëtimin e detyrimit prej **7,429,682 lekë** nga pronarët e lejeve të ndërtimit si më poshtë:

- z. Xh.N.në vlerën 43,920 lekë;
- z. R. T. në vlerën 782,818 lekë;
- z. I. H. dhe B. H. në vlerën 6,603,574 lekë.

Deri më 31.03.2020

3. Gjetje nga auditimi: Në auditimin e programimit dhe realizimit të të ardhurave, nga dhënia me qira e aseteve të Bashkisë Tepelenë subjekteve private, të cilat janë pajisur me leje minerare të miratuara nga “Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes”, për shfrytëzimin e sipërfaqeve pyjore dhe kullimore ku ushtrojnë aktivitetin e tyre për qëllime biznesi, për periudhën 01.01.2017 deri më 30.09.2019, u konstatua se:

-Në një rast nuk është lidhur kontratë qiraje me subjektin “K.” SHPK, pajisur me leje minerare shfrytëzimi për mineralin gurë gëlqeror, me vendndodhje në fshatin Luzat, Tepelenë, me sipërfaqe 1 (një) ha, me pasojë mos llogaritjen dhe mos arkëtimin e detyrimit në vlerën 1,209,994 lekë, të ardhura të munguara për buxhetin e njësisë vendore.

-Në një rast është lidhur kontratë qiraje me subjektin “C.” SHPK, pajisur me leje minerare shfrytëzimi për mineralin gurë gëlqeror, me vendndodhje në Bënçë, Tepelenë me sipërfaqe 3,3 ha, por nga detyrimi total që rrjedh nga kontrata e lidhur nuk është arkëtuar vlera 3,570,600 lekë, e ardhur e munguar për buxhetin e njësisë vendore.

-Në një rast, është lidhur kontratë qiraje nr. 53, datë 11.04.2011, me subjektin “I.” SHPK, me objekt dhënie në përdorim nga fondi Pyjor/kulloror një sipërfaqe prej 2,253 ha, për ndërtimin e Hidrocentralit “B. i L.”, me vendndodhje në fshatin Mezghoran”, Tepelenë, por nga subjekti nuk është kryer pagesa e plotë e detyrimit në vlerën 185,873 lekë.

Tre rastet e mësipërme i kanë shkaktuar buxhetit të njësisë vendore të ardhura të munguara në vlerën 4,966,467 lekë. Veprimi dhe mosveprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kërkesat e VKM nr. 391, datë 21.06.2006, “Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotave”, i ndryshuar, lidhja nr. 2, pikat 6 dhe 11 (*Më hollësisht trajtuar në pikën B2 faqe 25-42 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*)

3.1 Rekomandim: Nga titullari i njësisë vendore, drejtoria e zhvillimit ekonomik dhe menaxhimit financiar, të merren të gjitha masat e duhura ligjore, për arkëtimin e detyrimit në vlerën **4,966,467 lekë**, përkatësisht nga subjektet “K.” SHPK në vlerën 1,209,994 lekë, “C.” SHPK në vlerën 3,570,600 lekë dhe nga “I.” SHPK në vlerën 185,873 lekë.

Deri më 31.03.2020

4. Gjetje nga auditimi: Drejtoria e zhvillimit ekonomik dhe menaxhimit financiar, në 4 raste nuk ka përlllogaritur saktë dhe nuk ka arkëtuar tarifën për dhënie dhe rinovimin e licencave për njësitë e shitjes së lëndëve djegëse (karburante), që ushtrojnë veprimtarinë e tregimit të tyre për

përdorim nga konsumatorët fundorë, me pasojë të ardhura të munguara për buxhetin e njësisë vendore në vlerën **3,950,000 lekë**. Konkretisht janë subjektet: “K.” SHPK, “O.” SHPK “S.” SHPK, “K.” ShA. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kërkesat e VKM nr. 970, datë 2.12.2015 “Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj”, i ndryshuar me VKM nr.344, datë 19.04.2017 “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 970, datë 2.12.2015, të këshillit të ministrave, "për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj", kapitulli II, pika 1; germa “b”; pika 9 (Më hollësisht trajtuar në pikën B2 faqe 25-42 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

4.1 Rekomandimi: Nga titullari i njësisë vendore, drejtoria e zhvillimit ekonomik dhe menaxhimit financiar, të merren të gjitha masat e duhura ligjore, për arkëtimin e detyrimit prej **3,950,000 lekë** për mos rinovimin e licencave nga subjektet e tregtimit të karburanteve si më poshtë:

Subjekti “ K.” SHPK në vlerën 950,000 lekë, subjekti “O.” SHPK në vlerën 1,000,000 lekë, subjekti “S. G” SHPK në vlerën 1,000,000 lekë, subjekti “K.” ShA, në vlerën 1,000,000 lekë.

Deri më 31.03.2020

5. Gjetje nga auditimi: Nga IMTV për periudhën janar 2017 deri më 30.09.2019 janë vendosur 4 masa administrative me gjobë në vlerën totale 1,900,000 lekë, nga të cilat janë arkëtuar 500,000 lekë, ndërsa vlera prej **1,400,000 lekë** është ende e pa arkëtuar, e cila përbën të ardhura të munguara në buxhetin e njësisë vendore.

Gjobat e pa arkëtuara janë për z. R. S., me objekt rritje fiktive të çmimeve në vlerën 500,000 lekë, si dhe për subjektin “E. C. C.” SHPK, në vlerën 100,000 lekë, me objekt prishje e infrastrukturës, subjektin “K. K. ” SHPK në vlerën 800,000 lekë me objekt ndërtim pa leje. Afati ligjor i pagesë së gjobave (10 ditë) ka përfunduar, por nga njësia vendore nuk është bërë kërkesa në gjykatë për të nxjerrë urdhrin e ekzekutimit, me qëllim arkëtimin e gjobave, në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr.10279, datë 20.05.2010 ”Për kundërvajtjet administrative”, neni 9 -Ekzekutimi i kundërvajtjeve administrative; neni 22 -Vendimi për kundërvajtjen administrative, që parashikon dënimin me gjobë, si titull ekzekutiv”, neni 24- Shndërrimi i vendimit për kundërvajtjen administrative në titull ekzekutiv dhe neni 30-Arkëtimi i shumave të detyrimeve (Më hollësisht trajtuar në pikën B2 faqe 25-42 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

5.1. Rekomandim: Nga titullari i njësisë vendore, drejtoria juridike dhe ekonomike të merren masa për arkëtimin e vlerës **1,400,000 lekë**, duke kërkuar pranë organeve përkatëse (përmbarim, gjykatë), kthimin e tre vendimeve për kundërvajtjen administrative në titull ekzekutiv.

Deri më 31.03.2020

6. Gjetje nga auditimi: -Nga auditimi i programimit dhe realizimit të të ardhurave, konstatohet se nga drejtoria e planifikimit, zhvillimit dhe kontrollit të territorit, nuk janë marrë masa për arkëtimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë për objektet ndërtimore që legalizohen nga ALUIZNI- Drejtoria Rajonale Gjirokastrë. Sipas të dhënave zyrtare që ALUIZNI ka dërguar Bashkisë Tepelenë, konstatohet se deri më 30.09.2019, janë posedues të lejes së legalizimit që nuk kanë paguar detyrimet për taksën e ndikimit në infrastrukturë 24 persona për sipërfaqe ndërtimore gjithsej 7065 m², duke krijuar të ardhura të munguara për buxhetin e njësisë vendore, në vlerën **1,106,995 lekë**, sipas listës në aneksin e paraqitur në fund të Raportit të auditimit. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kërkesat e nenit 23 të ligjit nr. 9482 datë 03.04.2016 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, i ndryshuar, ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore” të ndryshuar (vendos nenin), VKM nr. 860, datë 10.12.2014 “Për përcaktimin e mënyrës së mbledhjes dhe administrimit të të

ardhurave për ndërtimet pa leje dhe veprave të zbatueshme për legalizim” i ndryshuar (vendos nenin), dhe Vendimet e Këshillit të Bashkisë nr. 2, datë 20.01.2017, VKB nr. 41, datë 21.12.2017 dhe VKB nr.74, datë 28.12.2018 “Për miratimin e taksave dhe tarifave vendore”, pika 10, të Bashkisë Tepelenë” (*Më hollësisht trajtuar në pikën B2, faqe 27-42 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

6.1 Rekomandim: Nga titullari i njësisë vendore dhe drejtoria e zhvillimit ekonomik dhe menaxhimit financiar dhe drejtoria e planifikimit, zhvillimit dhe kontrollit të territorit, në bashkëpunim me ALUIZNI dhe ZVRPP (Agjencia Shtetërore e Kadastrës) Tepelenë të merren të gjitha masat e duhura ligjore për arkëtimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë nga lejet e legalizimit në vlerën **1,106,995 lekë**, sipas listës së paraqitur në aneksin e Raportit të Auditimit.

Deri më 31.03.2020

7. Gjetje nga auditimi: Nga Bashkia Tepelenë në 16 raste, nuk është arkëtuar detyrimi që rrjedh nga kontratat e lidhura në periudhën 2008-2011, për dhënien me qira nga njësia vendore të tokave bujqësore të pandara, me afat 9 vjet, si dhe nuk janë llogaritur kamat vonesat për çdo ditë vonesë për mosarkëtimin në kohë të detyrimeve, me **pasojë të ardhura të munguara për buxhetin e njësisë vendore në vlerën 961,491 lekë** (principal 304,710 lekë, kamat vonesë 656,781 lekë). Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kërkesat dhe përcaktimet e bëra në VKM nr. 531, datë 21.8.1998 “Për tokat bujqësore të pandara”, i ndryshuar, UKM nr. 1, datë 18.7.2012 “Për procedurat e dhënies me qira të tokave bujqësore të pandara”, kreu V, pika 1,2,4,5, kërkesat e kontratës së lidhur mes palëve (*Më hollësisht trajtuar në pikën B2 faqe 27-42 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

7.1 Rekomandimi: Nga titullari i njësisë vendore, drejtoria juridike, drejtoria e zhvillimit ekonomik dhe menaxhimit financiar, të merren të gjitha masat e duhura ligjore, për arkëtimin e detyrimit prej **961,491 lekë**, për 16 kontratat e lidhura për dhënien me qira të tokës bujqësore.

Deri më 31.03.2020

C. MASA DISIPLINORE

Në mbështetje të shkronjës (c) neni 15 -Të drejtat dhe detyrat e KLSH-së, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, i **rekomandojmë** Kryetarit të Bashkisë Tepelenë, që të analizojë dhe ndajë përgjegjësitë për të gjithë personat që bëhen me përgjegjësi nga ky auditim, mbështetur Vendimin dhe në Raportin Përfundimtar të Auditimit, mbi bazën e performancës së gjithsecilit të aplikoj dhënien e masave disiplinore.

Masat disiplinore për punonjësit të cilët janë me status të nëpunësit civil të bazohen në nenin 58, “llojet e masave disiplinore”, të ligjit nr. 152/2013 datë 30.05.2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar me ligjin nr. 178/2014, datë 18.12.2014, ndërsa për punonjësit me kontratë, në nenin 37 dhe 144 të ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, dhe në kontratës individuale të punës.

D. NJOFTIMI I DEPARTAMENTIT TË ADMINISTRATËS PUBLIKE DHE KOMISIONERIT TË MBIKËQYRJES TË SHËRBIMIT CIVIL

Për punonjësit të cilët do të jepet masë disiplinore për sa më sipër, Bashkia Tepelenë, Njësia e Burimeve Njerëzore, pasi të zbatojë procedurat e nevojshme ligjore dhe nënligjore për fillimin e ecurisë disiplinore dhe pas përfundimeve të afateve ankimore, **të ndërmarrë veprimet si më poshtë:**

a. Të njoftojë Departamentin e Administratës Publike, për regjistrimin e masës disiplinore në Regjistrin Qendror të Personelit, në zbatim të neneve 7 dhe 17, të ligjit nr. 152/2013 "Për Nëpunësin Civil", i ndryshuar.

b. Të njoftojë Komisionerin për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, për mbikëqyrjen e ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil, në zbatim të nenit 11, të ligjit nr. 152/2013 "Për Nëpunësin Civil", i ndryshuar.

Me ndjekjen dhe kontrollin e zbatimit të detyrave dhe masave të përcaktuara në këtë vendim ngarkohet Departamenti i Auditimit të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore.

Bujar LESKAJ

K R Y E T A R